

Dje isha ne Irak,
Kalova Tigrin,
Arrita ne brigjet e lumit Euftrat.
Aty gjeta nje pllake guri me shkronja,
Ishte alfabeti i pare per njerezimin...
Mesova shkronjat e alfabetit,
Lexova Epopene e Gilgameshit,
Mesova edhe ligjin e pare te Hamurabit.
Shetita neper qendrat e civilizimit asirian,
Degjova legjendat e thurrura mbi Ashtarin,
Mepastaj, pushova nen hijen e drunjve te ullirit.

Me te zgjuar, e gjeta vehten ne pallatin e Reshidit,
Pas pak çastesh degjova tingujt e Zirjabit;
Prezentova ne mesimet e Me'munit,
Mesova fik'hun nga Ebu Hanifja;
Kalova disa çaste leximi ne Bejtu-l-Hikme;
Përfitova shumeçka nga devotshmeria e Abdu-l-Azizit...

Vizitova Kufen dhe Basren,
U bredha neper tregjet e Bagdadit.
Eca, kalova, mesova, dhe shumeçka perfitova...
Aty mesova historine e njerezimit,
Mesova kulturen dhe civilizimin njerezore, pasi,
Aty kishte filluar historia,

Aty ishin kultivuar vlerat e para kulturore, si dhe
Te arriturat e para te civilizimit...
Pas pak kohe, erdhen tataret barbare,
Erdhi edhe Holakoja i eger...
Shkaterruan gjithcka qe gjeten para vehtes...
Vranë njerëz të pafajshëm,
Dogjën gjithçka të vlefshme...
Pasi ngopen epshin e tyre shtazarak, shkuan...
Shkuan dhe u harruan në faqet e zeza të historisë...

Ndersa Iraku, mbeti i lënduar...
Për disa çaste, u mëkemb, u shërua nga plaget;
U kthye ashtu siç qe më parë,
Ashtu siç ishte për çdoherë,
çerdhe e civilizimit; kible e diturise...
U shendrua ne vend te amshueshem...

Mirepo, ky xhevahir i njerezimit,
Gjithmone ishte ne cak te kusareve,
Cdohere paraqitte objekt tamahi per barbare,
Per ato te cilet nuk respektojne gje tjeter, pos
Epsheve dhe instikteve te tyre shtazarake...
Dhe ja, sot, me te kthyer atje,
Irakun e gjeta ne tym e flake...!
Cdo gje ishte shendruar ne germadha...

Tigri dhe Eufirati ishin shendruar ne lumej gjaku...!
Anekand mbreteronte erë baroti...
Ne çdo ane dëgjohej piskama e femijeve...
Cdo gje ofkellonte, bile edhe historia dhe civilizimi...!!!
Barbaret ishin kthyer perseri !
Holakoja i shek. XXI ishte me i eger se kurdohere !
Kishin ardhur me gjithë makinerine e tyre destruktive,
Kishin ardhur te maskuar,
Me parrulla te rrejshme, dhe
Ne emer te "demokracise"...
Cdokund zbraznin mllefin e tyre kanibal...
Por jo;
Iraku, sikurse edhe cdohere, rezistonte...
Refuzonte t'i nenshtrohet kesaj kembe barbare,
Refuzonte kete mjerim te kohes dhe kete tragjedi te ekzistimit...
Cdo gje qe gjendej ne te rezistonte...
Bile edhe shkretetira e saj e lashte ishte ngritur ne kembe !
Lufta ne mes te mires dhe te keqes vazhdonte...!
Ndersa une, mbeta i deshpruar...
Madje, qava dhe derdha lote gjaku per kete vend te shenjte...
Mepastaj, u humba ne erresire !
Cdo gje u zhduk si ne humnere...
Vetem Iraku mbeti i amshueshem...
U shendrua ne legjende te gjalle sa te jete jeta...